

VENDIM
Nr. 746, datë 13.12.2017

**PËR SHPËRBLIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT E
FUNDVITIT, 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 18, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë përfitojnë kompensimin financiar në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas këtyre kategorive:

- a) Familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;
- b) Familje, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;
- c) Individë, përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
- ç) Individë, përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, prej 293 400 000 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë e katërqind mijë) lekësh, të përballohen, si më poshtë vijon:

- a) 101 400 000 (njëqind e një milionë e katërqind mijë) lekë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, miratuar për vitin 2017, për zërin “Shpenzimet korrente”, të ndara sipas programeve, përkatësisht, 64 000 000 (gjashtëdhjetë e katër milionë) lekë, në programin buxhetor “Kthimi dhe kompensimi i pronave”; 15 400 000 (pesëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë, në programin buxhetor “Shërbimi i provës”; dhe 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë në programin buxhetor “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”;
- b) 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, miratuar për vitin 2017, për zërin “Shpenzime korrente”, të ndara sipas programeve, përkatësisht, 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, në programin buxhetor “Zhvillimi rural, duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agro-industrial dhe marketingun”, dhe 1 000 000 (një milion) lekë në programin buxhetor “Administrimi i ujërave”;
- c) 176 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë për detajimin e fondeve sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama